



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI  
*Komisioni për Sigurinë Kombëtare*

Tiranë më 21.06.2016  
Dokument parlamentar

**R A P O R T**

**“Mbi Shqyrtimin e Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 9501, datë 04.04.2016,  
“Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.**

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 21 qershor 2016, në zbatim të nenit 86 të Rregullores së Kuvendit mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 9501, datë 04.04.2016, “Për kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

Në shqyrtimin të pretendimeve të ngritura në Dekretin e Presidentit për kthimin e ligjit, komisioni ftoi edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 19/2016, “Për masat shtesë të sigurisë publike”, duke u mbështetur në këto pretendime *(në mënyrë të përmbledhur)*:

**Arsyet e kthimit për rishqyrtim të ligjit nr. 19/2016, janë:**

- Përmes këtij ligji, duke përcaktuar masa shtesë të sigurisë, vendosjes së kamerave të sigurisë të cilat përfshijnë sheshe të hapura, parqe, kënde lojrash, mjedise të hapura apo të mbyllura publike, mjedise të punës ku ushtrohet një biznes privat, mjedise të hapura dhe të mbyllura për fëmijë, çënohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës së R.SH-së dhe neni 8/1 i KEDNJ-së.
- Ndërhyrja në të drejtën për jetë private dhe familjare përmes masave të parashikuara në nenin 8 të Ligjit nuk është e justifikueshme, e domosdoshme dhe proporcionale, pasi:

Neni 35 i Kushtetutës, krijon mundësinë e bërjes publike të të dhënave personale edhe pa pëlqimin e personit, nëse një gjë të tillë e "kërkon ligji" (paragrafi 1) ose në rastet e "parashikuara me ligj" (paragrafi 2). Një kufizim i tillë, në kushte të caktuara, gjen mbështetje edhe nga neni 17 i Kushtetutës (kufizimi të bëhet " ... vetëm me ligj, për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve ... "

Duke pasur parasysh edhe KEDNj si dhe jurisprudencën e GjEDNj-së, vlerësohet se rastet që do të justifikonin në tërësi kufizimin me ligj të kësaj të drejte do të ishin siguria kombëtare, mirëqenia ekonomike e vendit, mbrojtja e rendit kushtetues, parandalimi i veprave penale, mbrojtja e të drejtave dhe lirive të të tjerëve, etj. Në çdo rast konkret, legjitimitimi ose jo i ndërhyrjes do të varej kryesisht nga intensiteti i saj, shkalla e cenimit të jetës private, domosdoshmëria e kësaj ndërhyrje në shoqërinë demokratike dhe në realitetin konkret që e ka diktuar atë, efektiviteti dhe proporcionaliteti në raportin e qëllimit që është synuar të arrihet dhe mjeteve të përdorura për arritjen e tij. Mbi të gjitha duhet patur parasysh se sa më shumë të depërtohet në sferën e jetës intime apo sensitive, aq më shumë rritet edhe detyrimi i pushtetit publik për mbrojtjen e jetës private.

Udhëzimi nr.3/2010 i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka parashikuar përdorimin e kamerave të sigurisë CCTV si mjet dhe mënyrë e fundit, dhe që në rast se përdoret kërkon marrjen e pëlqimit me shkrim në mënyrë të detyrueshme nga 75 % e banoreve të pallatit. Gjithashtu, Udhëzimi përcakton detyrimin për informimin e subjekteve me qëllim që të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe në rast cenimi të privatësisë t'i drejtohen Komisionerit.

Ligji në fjalë mbasi detyron bizneset, administratorët e pallateve, shkollat private dhe publike, apo të gjitha institucionet publike të instalojnë kamera dhe të ruajnë përmbajtjen e tyre, nuk jep asnjë garanci se si do të ruhen të dhënat personale të individëve të siguruar nga këto kamera.

Neni 13 i Ligjit i jep të drejtë Policisë të marrë pamje filmike, ndërkohe që KPr.Penale përcakton qartë se diçka e tillë mund të realizohet veç përmes autorizimit të gjykatës. Ligji nuk përmban asnjë dispozitë që të garantojë të dhënat e përfutuara nga vendosja e mjeteve të regjistrimit-përgjimit. Kështu që, mundësia e keqpërdorimit të pamjeve filmike dhe të dhënave personale, shfrytëzimit për qëllime që nuk kanë lidhje me sigurinë, apo mundësia e keqpërdorimit të tyre nga ana e strukturave policore si mjet kërcënimi, diskreditimi publik apo për shantazh është evidente. Pra, ligji i miratuar nuk jep asnjë garanci lidhur me ruajtjen e privatësisë së qytetarëve.

- Ligji i miratuar bie ndesh me Direktivën 95/46 EC dhe dispozita e ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, pasi:

Ligji krijon mundësinë që përpunimi i të dhënave personale, i cili do të kryhet nga një prej sistemeve më të rëndësishëm, atë të video survejimit do të monitorohet nga ana e Policisë së Shtetit, pasi më parë ajo të ketë bërë vlerësimin e riskut dhe të ketë vlerësuar se ku do të vendosen kamerat, ndërkohë që kjo është kompetencë e Autoritetit të Pavarur të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Ligji nuk konsideron se të gjithë palët e përfshira në kuptim të ligjit janë 'Kontrollues', dhe si e tillë ata zgjedhin në mënyrë të pavarur mjetin dhe mënyrat me të cilat përpunojnë të dhënat personale. Në këtë mënyrë këto subjekte janë të detyruara të zbatojnë ligjin nr.9887 /2008 (i ndryshuar). Inspektimi në lidhje me këtë detyrim ligjor i takon Komisionerit, ndërkohë që në nenin 15 të ligjit kjo kompetencë i njihet ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

Neni 4/a i ligjit, që parashikon vendosjen e kamerave në ambientet e punës bie në kundërshtim me pikën 10/2 të Udhëzimit nr.1112011 "Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", të Komisionerit, i cili ndalon në mënyrë kategorike survejimit e punonjësve, pasi është në tejkalim të qëllimit.

Neni 11 sa i takon lëshimit të 'Vërtetimit të Sigurisë', organi dhe kriteret mbi të cilat jepet, përcakton si autoritet kompetent Policinë, ndërkohe që kjo i është njohur Komisionerit. Gjithashtu, në nenet 15 dhe 16 përcaktohen kompetenca të Policisë në drejtim të inspektimit për monitorimin e masave

shtesë të sigurisë dhe të vendosjes së gjobave në rast të mos marrjes së këtyre masave, ndërkohë që kjo është kompetencë e Komisionerit referuar ligjit 9887/2008.

**Si përfundim, Presidenti i Republikës, me anë të dekretit ka risjellë për rishqyrtim ligjin nr. 19/2016 në Kuvend me arsyetimin se bie ndesh me Kushtetutën e RSH, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën përkatëse të detyrueshme në Republikën e Shqipërisë.**

- Baza Ligjore mbi të cilën, Komisioni për Sigurinë Kombëtare shqyrton Dekretin e Presidentit:

**A. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**

**Neni 85**

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

**B. Rregullorja e Kuvendit**

**Neni 86**

**Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji**

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare bazuar në nenin 29/2 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit për relatimin e kësaj çështjeje, caktoi në cilësinë e Relatorit deputetin Xh. Qefalia, i cili parashtroi vërejtjet e tij mbi Dekretin, si vijon:

- *Lidhur me argumentin e Presidentit sa i takon cënimit të së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës së R.SH-së dhe neni 8/1 i KEDNJ-së, ky pretendim nuk qendron, sepse:*

Qëllimi parësor i këtij ligji është që nëpërmjet masave shtesë të ndërmarra me instalimin e sistemit të kamerave CCTV (*Closed-circuit television / qark i mbyllur transmetimi*) në kushtet e parashikuara në këtë ligj, ofrohet siguri më e lartë për individin dhe për pronën private e publike nga veprimtari të jashtëligjshme. Në asnjë moment ligji nuk shprehet se të dhënat e përftuara do të bëhen publike. Ky ligj respekton raportin proporcional e balancues midis jetës private e të dhënave personale në raport me garantimin e sigurisë publike, raport i cili duhet të garantojë njëkohësisht respektimin absolut të detyrimeve kushtetuese e ligjore që gëzojnë të drejtat e çdo individi në këtë aspekt. Siguria publike është një e mirë e përgjithshme dhe si e tillë ajo përmban

një interes të shtuar publik e cila duhet të ofrohet nga shteti me mjete e duhura ligjore me qëllim që ky shërbim/ofrimi i sigurisë mos të cenohet gëzimin e të drejtave të tjera.

Praktika e vendosjes së kamerave në hapësirat publike apo ambiente që paraqesin rrezik të shtuar është fenomen i njohur evropian dhe se Shqipëria është shumë mbrapa në këtë drejtim. Në të gjithë Evropën janë rreth 21 shtete që përdorin sistemin e survejimit me kamera, për sigurinë publike në hapësirat publike dhe private për të parandaluar krimin. Këto vende janë: Austri, Bullgari, Kroaci, Republika Çeke, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Lituani, Holandë, Norvegji, Poloni, Portugali, Spanjë, Suedi, Zvicër dhe Britani e Madhe.<sup>1</sup>

Çdo shtet mban në konsideratë hapësirën lejuese për përdorimin, përpunimin dhe mbrojtjen ligjore përkatëse mbi të dhënat personale dhe në këtë drejtim, legjislacioni i BE-së ka si pikë referuese Direktivën me nr. 95/46 EC të Parlamentit Evropian (v.2001).

Kjo direktivë paraqet edhe përjashtime e saja kur nuk mund të aplikohet drejtpërdrejtë, (neni 3 i Direktivës):

***“Kjo Direktivë nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave personale:***

- Në rrjedhën e një veprimtarie që bie jashtë sferës të së drejtës komunitare, të tilla si ato të parashikuara nga titujt e V dhe VI të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) dhe, në çdo rast të operacioneve të përpunimit në lidhje me sigurinë, **mbrojtjen, sigurinë publike të shtetit** (duke përfshirë mirëqenien ekonomike të shtetit, kur operacioni i përpunimit ka të bëjë çështjet e sigurisë) dhe aktivitetet e shtetit në fushën e të drejtës penale,

- Nga një person fizik, në rrjedhën e një aktiviteti ngushtësisht personale apo familjare.

Pra dy momente paraqet neni 3 i direktivës, veprimtari dhe masat e marra nga vet shteti për çështje të sigurisë dhe aktiviteti i mbledhjes së të dhënave, survejimi për qëllime ngushtësisht personale. Në të kundërt direktiva detyron që çdo autoritet, qoftë ai publik apo privat duhet të sigurojnë që të dhënat e mbledhura për operacione të ndryshme të kenë nivel sigurie që e përligj dhe e kërkon si legjislacioni i brendshëm dhe ai i bashkimit Evropian.

Ligji i kthyer për rishqyrtim, përcakton qartë se niveli i sigurisë mbi përpunimin dhe përdorimin e të dhënave të përfuara nga sistemi CCTV për qëllime të sigurisë publike i nënshtrohet autoritetit kontrollues të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 12 dhe 14 i ligjit). Ligji gjithashtu përcakton detyrimin e subjektit që do të instalojë kamera (neni 8/4) për të njoftuar individin me shenja përkatëse që për zonën e caktuar ekziston mundësia e flimit të tij.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, është ligj i cili në thelb transponon detyrimet e Direktivës nr. 95/46 EC të Parlamentit Evropian dhe rregullon autoritetin përkatës të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale. Përcaktimet ligjore si në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale ashtu edhe në ligjin për masat shesë të sigurisë publike respektojnë detyrimin kushtetues që parashikohet në nenin 35 të Kushtetutës. Vetë

<sup>1</sup> Inga Kroener, A Technology Under the Radar. United Kingdom, 2014

kushtetuta në këtë rast parashikon përjashtimin dhe ndërkohë lejimin që ligjvënësi për qëllime të caktuara mund të lejojë përpunimin dhe mbledhjen e të dhënave personale me ligj.

- *Lidhur me arsyen e dytë të parashtruar në dekretin e Presidentit, sa i takon ndërhyrjes në të drejtën për jetë private dhe familjare nuk është e justifikueshme, e domosdoshme dhe proporcionale, ky pretendim nuk qendron, pasi:*

Ligji për masat shitesë në sigurinë publike siç edhe parashtrova më sipër nuk ka asnjë qëllim për ndërhyrje në jetën private apo asaj familjare të individit apo bërjen publike të këtyre të dhënave. Në mbështetje të këtij pretendimi paraqitet vetëm aspekti teorik i praktikës së GJEDNJ-së por pa treguar asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me probleme të ligjit konkret. Referuar nenit 5 të ligjit, detyrimi i subjekteve për të marrë masa shitesë është për subjektet publike “*në sheshe të hapura, parqe, kënde të lojërave, parkime, në mjedise të hapura apo të mbyllura, që kanë në administrim apo pronësi dhe që, sipas vlerësimit të Policisë së Shtetit, përbëjnë burim rreziku të shtuar për rendin dhe sigurinë publike*”. Pra qëllimi është që shteti detyrohet që në ambiente tërësisht publike instalon kamera për qëllime të sigurisë publike dhe nuk mundet të lidhet me cënimin e privatësisë, përse kohë bëhet fjalë për hapësira publike.

*Në këtë pretendim Presidenti i referohet edhe të drejtës për privatësi në ambiente private apo të përbashkëta të pallateve për banim dhe nevojën që ligji duhet të parashikonte për vendosjen e kamerave në pallate, banorët duhet të japin pëlqimin e tyre në mënyrë të shprehur. “Gjithashtu pretendohet “se neni 13 i ligjit i jep të drejtë policisë të marrë pamje filmike, ndërkohë që KPr.Penale përcakton qartë se diçka e tillë mund të realizohet vetëm me autorizim të gjykatës”*

Ligji nuk cenon të drejtën për privatësi të banorëve në pallatet e banimit, pasi formulimi përkatës i nenit 3/1 dhe 6, është i tillë që banorët e pallatit për të ndërmarrë iniciativa për monitorimin me kamera, të bazoheshë në vullnetin e tyre dhe nuk është një detyrim i vendosur nga shteti. Pra nëse nga asambleja e bashkëpronarëve të pallatit, banorët do të gjykonin të nevojshme monitorimin me kamera për çështje sigurie do të ishin vetë ata që do mund të merrnin të tillë vendimmarrje.

Edhe pretendimi për marrjen e pamjeve filmike nga Policia e Shtetit jo në përputhje me përcaktimet e KPr.Penale nuk qëndron. Neni 13 i ligjit në të cilin është referuar edhe vetë Presidenti, është mjaftë i qartë kur përcakton se “*Subjektet e këtij ligji vënë në dispozicion materialet vizive apo të dhënat e tjera, që përfitohen nga përdorimi i masave shitesë të sigurisë, me kërkesë të Policisë së Shtetit ose organeve të drejtësisë, vetëm për nevoja hetimi, bazuar në Kodin e Procedurës Penale dhe në legjislacionin në fuqi*”.

Pra marrja e pamjeve filmike merret vetëm për qëllimi hetimi dhe sipas rregullave strikte të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale dhe legjislacionin përkatës.

Gjithashtu në dekretin e Presidentit pretendohet se ligji nuk përmban asnjë dispozitë që të garantojë të dhënat e përfutuara nga kamerat dhe mundësia e keqpërdorimit të pamjeve filmike dhe të dhënave personale, shfrytëzimi për qëllime që nuk kanë lidhje me sigurinë, apo mundësia e keqpërdorimit nga ana e strukturave policore si mjet kërcënimi dhe shantazhi është evidente.

Siç është theksuar edhe më sipër, ligji ofron të gjitha garancitë ligjore që çdo e dhënë, e marrë në funksion të këtij ligji do të mbrohet dhe trajtohet në përputhje të plotë me detyrimet kushtetuese dhe ato të përcaktuara në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kushdo që nuk do të respektojë këto garanci mban përgjegjësi civile e penale. Garancitë që ofron ligji nr.19/2016 në këtë drejtim i gjejmë në nenin 12, pikat 4 dhe 5, të cilat shprehen se “Subjektet, të cilat instalojnë sistemin e kamerave apo pajisje elektronike të teknologjisë së lartë, njoftojnë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi procedurat e kryerjes së çdo veprimi tërësisht ose pjesërisht automatik të përpunimit dhe transmetimit të të dhënave personale, të marra në zbatim të këtij ligji.

Niveli i sigurisë për përpunimin e të dhënave personale nëpërmjet sistemeve të sigurisë përcaktohet me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu neni 14 i ligjit përcakton se “Përpunimi i të dhënave personale të përfituara nga sistemet e sigurisë, të parashikuara në këtë ligj, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale”

- Lidhur me arsyen e tretë, sa i takon se ligji bie ndesh me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, vlerësojë se argumentat e parashtruara në dekretin e Presidentit janë të pabazuara për sa vijon:

**Së pari**, ligji nuk dublon asnjë kompetencë ku policia e shtetit të përpunojë dhe të marrë të dhëna personale, apo të monitorojë këto të dhëna ndërkohë që kjo është kompetencë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për më tepër të pretendosh se ligji nuk konsideron se të gjithë palët e përfshira në kuptim të ligjit janë 'Kontrollues', dhe si e tillë ata zgjedhin në mënyrë të pavarur mjetin dhe mënyrat me të cilat përpunojnë të dhënat personale, ndërkohë që ligji në nenet 12, 13 dhe 14 siguron krejt të kundërtën kur shprehet se asnjë përpunim, transmetim i të dhënave personale të përfituara për qëllime të këtij ligji nuk do të bëhet pa marrë konfirmimin dhe pa kontrollin e autoritetit përgjegjës, Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**Së dyti**, neni 6 i ligjit nuk duhet kuptuar si pushtet i pakufizuar i policisë së shtetit siç pretendohet. Vlerësimi i riskut dhe analiza mbi elementë që mund të cenojnë sigurinë publike normalisht nga struktura që janë përgjegjëse do të kryhet, e cila është Policia e Shtetit.

Të gjitha subjektet janë të detyruara të zbatojnë ligjin nr.9887/2008 mbi mbrojtjen e të dhënave personale (i ndryshuar). Inspektimi në lidhje me këtë detyrim ligjor i takon Komisionerit dhe jo ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë. Neni 15 në të cilën është referuar Presidenti nuk ka të bëjë me inspektimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore që përcaktohen në ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale por vetëm për përmbushjen e detyrimeve ligjore që përcakton ligjin nr.19/2016 në rastet kur nga analiza e strukturave të policisë së shtetit, subjekti përkatës rezulton me risk të lart dhe ka marrë njoftim për instalim kamerash dhe nuk e ka kryer.

**Së treti**, Lëshimi i “Vërtetimit të Sigurisë” përcaktuar në nenin 11 të ligjit nuk është kompetencë ligjore e Komisionerit siç pretendohet. Ligji nr. 9887/2008, i ndryshuar, nuk ka asnjë dispozitë ku ti njoh një kompetencë të tillë Komisionerit, lëshimin e “vërtetimit të sigurisë”. Vërtetim sigurie është akti administrativ që lëshon Policia e Shtetit dhe që vërteton plotësimin e masave shtesë të sigurisë të marra nga subjektet.

E drejta për respektimin e jetës private është, megjithatë, jo një e drejtë absolute, por duhet të jetë i balancuar dhe në pajtim me interesat e tjera legjitime, qofshin ato të personave të tjerë (interesave private) ose i shoqërisë si një e tërë (interesi publik).

Kushtet në të cilat ndërhyrja e shtetit është e justifikuar janë:

- Ndërhyrja duhet të jetë në përputhje me ligjin. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, ndërhyrja është në përputhje me ligjin në qoftë se ajo është e bazuar në një dispozitë të ligjit të brendshëm, i cili ka cilësi të caktuara. Ligji duhet të jetë "në dispozicion të personave në fjalë dhe të parashikojë efektet e tij"<sup>2</sup>. Në rastin konkret ligji i kthyer nr.19/2016 referon dhe respekton ligjin nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ligj i cili respekton bazat dhe kërkesat e Direktivës nr. 9546/EC.
- Norma ligjore në këto raste duhet të jetë e formuluar me saktësi të mjaftueshme për t'i mundësuar çdo individ - nëse është e nevojshme me këshillimin e duhur - të rregullojë gjëndjen dhe sjelljen e tij si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tij<sup>3</sup>.

Si përfundim, Relatori i çështjes theksoi se ligji nr. 19/2016 "Për masat shtesë në sigurinë publike" është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Detyrimi për marrjen e masave shtesë është i lidhur ngushtë edhe me rritjen e angazhimit të Policisë së Shtetit për kontrollin e territorit, sigurimin e jetës dhe të pronës së shtetasve shqiptarë dhe reagimin e shpejtë për çdo ngjarje dhe identifikimin e autorëve të tyre.

➤ **Sa më sipër, Relatori i sugjeroi komisionit, rrëzimin e Dekretit të Presidentit nr.9501, datë 04.04.2016.**


Gjithashtu gjatë diskutimit të kësaj çështjeje në komision, opozita ngriti shqetësimin se ligji nr. 19/2016, përpos faktit se përmban element për antikushtetutshmëri të shprehura edhe në Dekretin e Presidentit të Republikës, gjatë hartimit të tij nuk ka respektuar sugjerimet e PAMECA<sup>4</sup> si dhe vërejtjet e ICITAP<sup>5</sup> mbi problemet që përmban projekti për vendosjen e kamerave.

Nisur nga sa më lartë, me pjesëmarrjen e 13 anëtarëve të pranishëm, Komisioni për Sigurinë Kombëtare në lidhje me këtë çështje në përfundim të diskutimeve, vendosi duke votuar:

- 6 anëtarë të komisionit, votuan kundra Dekretit të Presidentit;
- 4 anëtarë të komisionit, votuan abstenim;
- 3 anëtarë të komisionit, votuan pro Dekretit të Presidentit.


Sa më sipër, Komisioni për Sigurinë Kombëtare ja kalon këtë çështje për diskutim, Seancës Plenare të vendosë në përputhje me nenin 85/2 të Kushtetutës.

Relator  
Xhemal Qefalia



Kryetar

Spartak BRANO



<sup>2</sup> GJEDNJ, Amann v. Switzerland [GC], nr. 27798/95, 16 shkurt 2000, para. 50; shih gjithashtu GJEDNJ, Kopp v. Zvicërës, nr. 23224/94, 25 mars 1998, para. 55 dhe GJEDNJ, Iordachi dhe të tjerë k. Moldavisë, nr. 25198/02, 10 shkurt 2009 para. 50.

<sup>3</sup> GJEDNJ, Amann v Zvicër [GC], nr. 27798/95, 16 shkurt 2000.; shih gjithashtu GJEDNJ, Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 8691/79, 2 gusht 1984.

GJEDNJ, Silver dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar, nr. 5947/72, 6205/73, 7052/75, 7061/75, 7107/75, 7113/75, 25 mars 1983.

<sup>4</sup> PAMECA është projekti nga Asistenca e BE për Shqipërinë, në kuadër të programit IPA.

<sup>5</sup> Programi i Asistencës Ndërkombëtare për Trajtime mbi Hetimet Penale (US Justices Department).